



8-14 SHTATOR

JAVA E MBROJTJES

FORCIMI I SIGURISË DHE PROJEKTEVE STRATEGJIKE

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, Gjenerallejtënant Arben Kingji, morën pjesë në takimin e Kryeministrit Edi Rama me Komandantin e Forcave Detare të Shteteve të Bashkuara në Europë dhe Afrikë, Admiralin Stuart B. Munsch. Takimi u zhvillua në kuadër të hapave që Shqipëria po ndërmerret për rilindjen e industrisë ushtarake dhe për ecurinë e projekteve strategjike, si Korridori VIII dhe Porti i Ri i Durrësit.

★★★★★



MINISTRI VENGU PRET BORIS RUGE

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, priti Asistent Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Ambasador Boris Ruge, në një takim ku u diskutuan sfidat e sigurisë dhe roli i Shqipërisë brenda Aleancës. Gjatë vizitës inspektuan Portin e Porto Romanos, një vend kyç për infrastrukturën dhe operacionet strategjike të vendit.

JM





MË SHUMË TË RINJ ZGJEDHIN FA

Gjatë vitit të fundit, regjistrimet për ushtar/detar/ajror në Forcat e Armatosura janë rritur me mbi 34%, duke treguar besimin dhe interesin e të rinjve për të shërbyer në FA. Modernizimi i strukturave, përmirësimi i kushteve të punës dhe mundësitë e reja të karrierës kanë bërë që uniforma ushtarake të jetë më tërheqëse për të rinjtë.

JM





MINISTRI VENUGU NË “DIPLO 2025”

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu mori pjesë në konferencën e ambasadorëve “DIPLO 2025”, ku theksoi se mbrojtja dhe diplomacia janë sot më të ndërlidhura se kurrë. Ai foli për zhvillimin e industrisë ushtarake, modernizimin e kapaciteteve luftarake, kërcënimet dhe përgjegjësitë e reja që shfaqen si dimension i ri i diplomacisë shqiptare, si dhe për rolin e Shqipërisë si faktor sigurie në Evropën Juglindore.

★★★★★

EOD VIJON PASTRIMIN E MUNICIONEVE NË DISA BASHKI

Misioni i efektivëve të Kompanisë EOD të Batalionit të Xhenios për pastrimin e territorit nga municione të identifikuara në vazhdon në bashkitë Tiranë, Vorë, Mirditë dhe Dibër. Ekspertët e kualifikuar bëjnë vlerësimin e municioneve të kalibrave të ndryshëm, transportimin dhe asgjësimin e sigurt të tyre, duke mbrojtur jetën dhe pronën e popullsisë civile.

JM

★★★★★



MIRËNJOHJE PËR ATASHEUN AMERIKAN

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, së bashku me komandantët e forcave dhe ekipin drejtues të Ministrisë së Mbrojtjes, përshëndeti Kapitenin Eric Cote me rastin e përfundimit të detyrës si atashë ushtarak amerikan në Shqipëri. Gjatë mandatit të tij, skuadra e Bashkëpunimit Ushtarak pranë Ambasadës së SHBA-së dhe pesë këshilltarët amerikanë të integruar në Ministrinë e Mbrojtjes dhanë kontribut të madh në modernizimin e Forcave të Armatosura shqiptare.

★★★★★



AFA HAP APLIKIMET PËR PROGRAMET MASTER 2025–2026

Akademia e Forcave të Armatosura hap aplikimet për programet Master për vitin akademik 2025–2026. Programet e ofruara janë: Master Profesional në Siguri Kibernetike në fushën e mbrojtjes (25 kuota) Master Shkencor në Siguri dhe Politikë Ndërkombëtare (35 kuota). Master Shkencor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale (30 kuota) Për informacion mbi afatet, kriteret dhe dokumentacionin, vizitoni faqen zyrtare të AFA: afa.mil.al.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

TRAJNIM PËR KËRKIM-SHPËTIM MALOR

Në kuadër të bashkëpunimit me Forcën e Sigurisë së Kosovës, efektivë të kompanisë së parë operacionale në BMEC përfunduan trajnimin e kërkim-shpëtimit malor në Qendrën Ndërkombëtare të Trajnimeve për Kërkim-Shpëtimin në Pomozatinë, Kosovë. Ata përvetësuan njohuri teorike dhe zhvilluan veprime praktike për kërkimin e të plagosurve, evakuimin, ndihmën e parë dhe kalimin e pengesave ujore.

★★★★★

mod.gov.al

JM